



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 448/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Ferit Osmanit anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterit më afër se 100 m nga Qendra e Votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e parregullt ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 03.11.2013, për Qendren e Votimit (QV) 111B shkolla fillore „Bajram Curri” në Vidimiq me te cilen pretendohet se është vendosur poster i kandidatit për Kryetar të Mitrovicës nga Aleanca Kosova e Re, më afër se 60 metra afër vendvotimit. Me kete rast parashtresesi i ankesës konsideron se ky veprim është në kundërshtim më nenin 36 dhe neni 85 të LZP-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj rregullsinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e parregullt

PZAP-i konstaton se ankesa e subjektit politik PDK është e parregullt pasi që ankesa nuk është vërtetuar nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes e ankesës, andaj duke u bazuar në nenin 3.6 pika d, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 448/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*